



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 11, datë 12.03.2020

PËR

MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR PROGRAMET E PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR STREHIM

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Aktin normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, VKM-së nr. 750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në Qarqet Tiranë Durrës”, VKM-së nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të proçesit të rindërtimit”, VKM-së nr. 5, datë 6.1.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Punëve Publike, Sektori i Strehimit, me propozim të Zëvendëskryetarit Bashkisë z.Zhuljen Varfaj, i cili kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Të miratojë sistemin e pikëzimit, për individët/familjet, që kanë humbur familjarë dhe/ose kanë mbetur të pastrehë si pasojë e fatkeqësisë natyrore si dhe për plotësimin e nevojave të tyre nga programet e proçesit të rindërtimit, sipas Tabelës nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme AKRSKF dhe Burimeve Njerëzore, si dhe Drejtoria e Bujqësisë, Pyjeve, Shërbimit Veterinar dhe Emergjencave Civile, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 12.03.2020

Tabela nr.1

**SISTEMI I PIKËZIMIT PËR PROGRAMET E PROÇESIT TË
RINDËRTIMIT PËR STREHIM**

	KRITERET E PIKËZIMIT	Pikët
A	Familje që kanë humbur familjarët nga fatkeqësia natyrore.	25
B	Familje një prindërore që kanë në ngarkim fëmijë ku përfshihen dhe vajzat nëna.	15
C	Familjet që kanë në përbërje personat me aftësi të kufizuara.	15
Ç	Të moshuarit që kanë mbushur moshën e pensionit.	20
D	Familjet në skemën e ndihmës ekonomike.	15
DH	Të rënë në krye të detyrës.	10

Shënim!

Pikët maksimale që mund të përfitojë një individ/familje janë 100 pikë. Pikët mund të mbledhen brenda për brenda një kriteri.